



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 55

Tiranë – E martë, 21 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 15.3.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.....
	3317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 15.3.2017	Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre.....
	3333
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 190, datë 15.3.2017	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, në njësinë administrative Mollas, të pronës me numër pasurie 321, në zonën kadastrale 2691, me sipërfaqe 19350 m ² , dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1087, datë 23.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Mollas, të qarkut të Korçës”.....
	3334
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 15.3.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5 044.85 m ² , dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1 580.89 m ²
	3337
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 15.3.2017	Për shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 13.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, nga Ministria e Brendshme Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik”.....
	3339
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017	Për përcaktimin e mënyrave, formave, kritereve dhe rregullave për organizimin e lojërave të fatit promocionale.....
	3339

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 15.3.2017	Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018–2020.....	3341
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 15.3.2017	Për disa shtesa në numrin e punonjësve për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për vitin 2017.....	3343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 15.3.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive të Ministria e Financave, për Degën e Thesarit Sarandë, të një ambienti në pronën nr. 13/125-M7, në zonën kadastrale 8641, me vendndodhje në adresën “Lagja nr. 1”, në qytetin e Sarandës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”.....	3343
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 15.3.2017	Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit.....	3346
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 15.3.2017	Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Burgjeve.....	3354
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 15.3.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.....	3355
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 15.3.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, dhe transferimin e tij nga Ministria e Zhvillimit Urban te Bashkia Tiranë, për realizimin e pagesës së detyrimit të prapambetur për shoqërinë “Urbaplan”.....	3358
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 15.3.2017	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik Eolik, dhënë shoqërisë “ALB-Building” sh.p.k.....	3358
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 15.3.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të ndryshuar.....	3363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 15.3.2017	Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.....	3363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 15.3.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban, shesh, park publik, teatri ‘Petro Marko’”, në Bashkinë Vlorë.....	3368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 15.3.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 678, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, vënia në punë, administrimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve të Gojanit, Gjegjanit, Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut”, të ndryshuar.....	3371

**VENDIM****Nr. 188, datë 15.3.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË
SISTEMIN E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE SPITALIN
USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR,
NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
MBROJTJES, TË PUNONJËSVE TË
INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË E
MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE
PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË
STRUKTURAT E FORCAVE TË
ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në titullin e vendimit fjalët “...dhe Spitalin Ushtarak Qendror...”, zëvendësohen me “...dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës...”;

b) Në shkronjën “c”, të pikës 1, të vendimit, fjalët “...në Spitalin Ushtarak të Forcës Tokësore”, zëvendësohen me “...në Njësinë Mjekësore

Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës...”;

c) Në pikën 1, të vendimit, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të Shëndetësisë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.”;

ç) Lidhja nr. 1 (kreu 1.1–1.9), e përmendur në pikën 2, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 1 (kreu 1.1 - 1.10), që i bashkëlidhet këtij vendimi;

d) Lidhja nr. 2 (kreu 2.1–2.8), e përmendur në pikën 3, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 2 (Kreu 2.1- 2.8), që i bashkëlidhet këtij vendimi;

dh) Lidhja nr. 5, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademik, në Institutin e Shëndetit Publik”, e përmendur në pikën 2.1, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

e) Lidhja nr. 6, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Institutin e Shëndetit Publik”, e përmendur në pikën 2.2, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ë) Lidhja nr. 7, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e laboratorit në Institutin e Shëndetit Publik”, e përmendur në pikën 2.3, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr. 1, kolona 1 e lidhjes nr. 2, kolona 3 e lidhjes nr. 6 dhe kolona 1 e lidhjes nr. 7) sipas nivelit arsimor në të gjitha institucionet, pjesë përbërëse të këtij vendimi, është sipas lidhjes, nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi.”;

g) Pika 3.1, shfuqizohet;

gj) Shkronja “a”, e pikës 12/1, ndryshon si më poshtë vijon:

“a) Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje u jepet një shpërblim:

Në qendrat spitalore universitare:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e shtuna	7 000 lekë	6 400 lekë
Për ditët e diela e festat	8 000 lekë	7 600 lekë



Në institucionet e tjera:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	5 600 lekë	5 200 lekë
Për ditët e shtuna	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e diela e festat	7 000 lekë	6 600 lekë

h) Pas pikës 12/4 shtohen pikat 12/5, 12/6 dhe 12/7, me këtë përmbajtje:

“12/5. Mjekët e spitaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës, në njësinë e aksidenteve cerebrale, si dhe mjekët neonatë, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/6. Infermierët dhe laborantët e spitaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës dhe në njësinë e aksidenteve cerebrale përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/7. Mjekët, të cilët në zbatim të sistemit të referimit dërgohen për konsulta dhe ndërhyrje kirurgjikale në spitale të tjera, përfitojnë për çdo ditë shërbimi një shtesë në page, si më poshtë vijon:

a) mjekët e institucioneve spitalore universitare 10 000 lekë;

b) mjekët e spitaleve rajonale 5 000 lekë.”.

i) Lidhja nr. 4, e përmendur në pikën 13, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 4, “Nivelet e pagave për mjekët me tituj e grada shkencore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, do të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave, dhe nga fondet e shpërndara për Fondin e Detyrueshëm të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2017 e në vijim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA 1 (KREU 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK NR. 1, NR. 2 TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR TË SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE “SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS TIRANË, SI DHE MJEKËT DHE PUNONJËSIT E TJERË CIVILË ME ARSIM TË LARTË NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS

PAGA MUJORE							
	EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor i: - QSU “Nënë Tereza” Tiranë; - Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë; - Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë; - Spitalit të Sëmundjeve të Mëshkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë; - Spitalit Universitar të Traumës	1	2%	0	118.600		Nga... deri ... Lekë



2	Drejtor i Klinikës Stomatologjike Universitare Tiranë. Zëvendësdrejtor i QSU-së "Nënë Tereza" Tiranë	1	2%	0	100.900		
3	Zëvendësdrejtor në spitalet e tjera universitare	1	2%	0	81.800		
4	Shef Shërbimi infektiv në QSUT	1	2%	0	71.700	8000	
5	Shef Shërbimi. Shef i Sektorit Biomedikal	1	2%	0	71.700		
6	Shef reparti infektiv në QSUT	1	2%	0	62.700	8000	
7	Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.) Shef i Qendrës së Gruas	1	2%	0	62.700		
8	Shef reparti/klinike reanimacioni	1	2%	0	62.700	1100	
9	Shef reparti/klinike psikiatrie	1	2%	0	62.700	5000	
10	Shef i Laboratorit Klinik Biokimik Shef reparti kimioterapi Shef laborator Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare	1	2%	0	62.700	2200	
11	Shef Reparti Rrezatimi Shef Reparti i Kyrisë	1	2%	0	62.700	4600	
12	Shef kabineti Shef i Qendrës së Protezimit. Inxhinier biomedikal	1	2%	0	56.650		
13	Shef sektori Shef farmacie në solucionet e injektueshme Biokimist në solucionet e injektueshme Inxhinier i sistemeve të ngrohjes Inxhinier hemodialize	1	2%	0	56.650		
14	Mjek Stomatolog Biolog, kimist, fizikant në preparatori Mikrobiolog, parazitolog, virolog, mykolog Përgjegjës qendre DDD Specialist fizikulture (fizioterapi neurologji)	1	2%	0	53.000		
15	Mjek infeksionist në QSUT	1	2%	0	53.000	8000	
16	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale) Mjek onkolog Mjek fizioterapevt Mjek obster gjinekolog Mjek pneumoftiziatër	1	2%	0	53.000	1100	
17	Mjek radilolog Toksikolog, kimist, në laboratorin toksikologjik Kimist në laboratorin biokimik Fizikan në laboratorin biokimik Biolog në laboratorin biokimik	1	2%	0	53.000	1600	
18	Mjek radiolog, në shërbimin infektiv në QSUT Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUT	1	2%	0	53.000	8000	
19	Mjek kimioterapeut Mjek hematolog Mjek infeksionist	1	2%	0	53.000	2000	



	Mjek në pranim urgjence Mjek në njësinë nozokomiale Mjek laborator Mjek histopatolog Mjek në shërbimin e gjakut						
20	Mjek në Inspektoratin Sanitar Inspektor sanitar Epidemilog Farmacist	1	2%	0	53.000	2500	
21	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik Mjek laborator izotopik Fizikant, kimist laborator izotopik Mjek në hemodinamikë Fizikan në higjienë dhe epidemilogji Inxh. kimist në shërbimin e higjienës Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike	1	2%	0	53.000	2800	
22	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziat, reanimator Mjek në pavijonin e rrezatimit Mjek në pavijonin e Kyrisë Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Fizikan kobalti	1	2%	0	53.000	3700	
23	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri	1	2%	0	53.000	5000	
24	Inspektor auditit. Specialist	1, ose 2, ose 3	2%	0	39.000		

LIDHJA 1 (KREU 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË
RAJONALE DHE VENDORE TË SHËNDETIT PUBLIK DHE AUTORITETIN
SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Titullar i drejtorive rajonale të Shëndetit Publik. Titullar në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës	1	2%		81.800	9000	Nga... deri ... lekë
2	Titullar i drejtorive vendore të shëndetit publik.	1	2%		71.700	9000	
	Zëvendëstitullar në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës				62.700		
3	Drejtor drejtorie në Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës	1	2%		62.700		
4	Zëvendëstitullar në drejtoritë rajonale të shëndetit publik	1	2%		62.700		



5	Shef shërbimi	1	2%		55.000		
6	Shef shërbimi i Kontrollit të sëmundjeve infektive Shef shërbimi në epidemiologji	1			55.000	9000	
7	Shef Shërbimi Stomatologjik	1	2%		55.000	3300	
8	Përgjegjës i Shërbimeve të Shëndetit Mendor	1	2%		49.500	5000	
9	Shef sektori Shef/përgjegjës laborator	1	2%		42.000		
10	Specialist në shërbimin e shëndetit mjedisor Specialist në higjienë	1	2%		42.000	7000	
11	Epidemiolog Higjienist	1	2%		42.000	8000	
12	Shef reparti në shërbimin e shëndetit mjedisor Shef reparti në higjienë	1	2%		42.000	9000	
13	Mjek Stomatolog Inxhinier elektrik Kimist Veteriner Mikrobiolog	1	2%		42.000		
14	Mjek laborator	1	2%		42.000	1600	
15	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Shërbimet e Shëndetit Mendor	1	2%		42.000	5000	
16	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		34.200		
17	Specialist promocioni	1 ose 2 ose 3	2%		34.200	4000	

LIDHJA I (KREU 1.3)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË SPITALET
E RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT
TË FËMIJËVE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		81.800		Nga... deri ... lekë
2	Shef Shërbimi në Anatomopatologji	1	2%		62.700	3500	
3	Zëvendësdyrejtor. Njësinë Mjekësore	1	2%		56.100		
4	Shef shërbimi	1	2%		55.000		
5	Shef Shërbimi Reanimacioni Shef Shërbimi Infektiv Shef Shërbimi Obstetrik Gjinekologjik	1	2%		55.000	1100	



	Shef Shërbimi Kirurgji Shef Shërbimi Ortopedi						
6	Shef Shërbimi Radiologji Shef Shërbimi Neuropsikiatri	1	2%		55.000	1600	
7	Shef Shërbimi Psikiatri	1	2%		55.000	5000	
8	Shef reparti/klinike Përgjegjës/shef kabineti Përgjegjës/shef laborator /Poliklinike/fizioterapi	1	2%		42.000		
9	Shef i Bankës së Gjakut Shef Reparti Radiologjie Shef Reparti pneumoftiziatri	1	2%		42.000	1100	
10	Shef reparti/klinike Psikatri	1	2%		42.000	5000	
11	Përgjegjës laborator klinik biokimik	1	2%		42.000	2500	
12	Përgjegjës/shef reparti Anatomopatologji	1	2%		42.000	3700	
13	Mjek Stomatolog Biolog Kimist Fizikan Shef sektori Inxhinier biomedikal	1	2%		42.000		
14	Mjek infeksionist Mjek urgjence Mjek laborator Kimist, fizikan laborator Kimist në Shërbimin e Gjakut	1	2%		42.000	1100	
15	Mjek onkolog Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale) Mjek hematolog Mjek i bankës së gjakut Mjek obstetër gjinekolog Mjek pneumoftiziatër Mjek fizioterapevt	1	2%		42.000	1100	
6	Mjek radiolog	1	2%		42.000	1600	
17	Mjek higjienist Farmacist	1	2%		42.000	2500	
18	Mjek anatomopatolog Mjek anesteziat reanimator	1	2%		42.000	3700	
19	Mjek, psikolog, punonjës socialë që punojnë në Psikiatri	1	2%		42.000	5000	
20	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		34.200		



LIDHJA I (KREU 1.4)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		81.800		Nga ... deri ... lekë
2	Zëvendësdrejtor	1	2%		71.700		
3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave	1	2%		62.700		
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	1	2%		50.500		
5	Farmacist Analist	1	2%		50.500	4000	
6	Farmacist Inspektor për Kontrollin Farmaceutik	1	2%		50.500	5000	
7	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		34.200		

LIDHJA 1 (KREU 1.5)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		69.000		Nga ... deri ... lekë
2	Shef sektori	1	2%		55.000		
3	Mjek. Stomatolog	1	2%		42.000		
4	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		42.000		



LIDHJA 1 (KREU 1.6)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
INXHINIERISË BIOMJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		71.700		Nga ... deri ... lekë
2	Shef sektori	1	2%		55.000		
2	Përgjegjës i zyrës teknike Përgjegjës reparti	1	2%		47.850		
3	Inxhinier biomedikal	1	2%		42.000		
4	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		34.200		

LIDHJA 1 (KREU 1.7)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN E
TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		81.800		Nga ... deri ... lekë
2	Zëvendës drejtor	1	2%		62.700		
3	Përgjegjës i Sektorit të Laboratorëve Shef i Bankës së Gjakut	1	2%		55.000	2500	
4	Shef sektori	1	2%		42.000		
	Mjek, kimist	1	2%		42.000	1600	
6	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		34.200		



LIDHJA I (KREU 1.8)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor i përgjithshëm	1	2%		118.600		Nga ... deri ... lekë
2	Zëvendësdyrejtor i përgjithshëm	1	2%		100.900		
3	Drejtor drejtorie	1	2%		81.800		
	Përgjegjës sektori	1	2%		71.700		
4	Specialist (mjek)	1	2%		53.000	2000	
5	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		50.500		

LIDHJA 1 (KREU 1.9)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN
KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË, AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE
SHËNDETËSORE DHE QENDRËS KOMBËTARE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Drejtor	1	2%		100.900		Nga ... deri ... lekë
2	Shef sektori	1	2%		62.700		
3	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%		50.500		

LIDHJA 1 (KREU 1.10)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT NË NJËSINË E HELIKOPTERËVE TË
TRANSPORTIT MJEKËSOR TË SHËNDETËSISË
NË STRUKTURAT E MINISTRISË SË MBROJTJES

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryepilot	1	2%		81.800	8000	Nga ... deri ... lekë
2	Pilot	1	2%		78.100	8000	
3	Teknik Helikopteri fluturues	1	2%		74.800		



LIDHJA NR. 2 (KREU 2.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA” TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË “SHEFQET NDROQI” TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS TIRANË, SI DHE INFERMIERËT CIVILË NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i Sektorit të Kujdesjeve Infermiore		2%	0	37.400	3600	Nga ... deri
2	Kryeinfermier Shërbimi Psikiatrik		2%	0	37.400	6000	
3	Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në QSUT		2%	0	37.400	8000	
4	Kryelaborantë në Shërbimin e Anatomisë Patologjike. Kryeinfermier Shërbimi i Terapisë Intensive. Kryeinfermiere Shërbimi Onkologjik. Kryelaborant Rrezatim Kobalti. Kryelaborant në Histopatologji. Kryeinfermierë të Repartit të Rrezatimit		2%	0	37.400	3400	
5	Kryeinfermierë Reparti Psikiatrik		2%	0	37.400	5000	
6	Kryeinfermierë Reparti në Shërbimin Infektiv në QSUT		2%	0	37.400	8000	
7	Kryeinfermierë shërbimi Neurokirurgji. Kryemami e përgjithshme. Kryeinfermier/kryemami reparti i Terapisë Intensive		2%	0	37.400	2600	
8	Kryeinfermierë kimioterapi. Kryelaborant klinik biokimik. Kryeinfermiere në urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme. Kryeinfermejere/mami salle. Kryeinfermiere/mami e dhomës së zgjimit. Infermierë në hemodinamikë. Kryelaborant imunolog,bakteriolog.		2%	0	37.400	1800	
9	Kryeinfermierë shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatri infektive, obstetrik). Kryeinfermier/kryemami në Repartin e Kirurgjisë. Kryemami turni në Kirurgji. Kryemami turni në Obstetrikë. Kryeinfermierë Reparti Infektiv. Kryeinfermierë reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji).		2%	0	37.400	1100	



	Kryeinfermiere/kryemami 10ale operacioni						
10	Kryeinfermiere shërbimi. Kryelaborante shërbimi. Kryemami shërbimi		2%	0	37.400		
11	Infermier/laborant në psikiatri		2%	0	35.200	5000	
12	Infermierë në kyriterapi. Laborant histopatolog		2%	0	35.200	3400	
13	Infermier/mami reanimacioni, neonatologji. Infermiere në dhomën e zgjimit		2%	0	35.200	2650	
14	Infermiere në kimioterapi		2%	0	35.200	1800	
15	Kryelaborant radiologjie		2%	0	35.200	1500	
16	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore. Kryeinfermiere e edukimit shëndetësor TB		2%	0	35.200	1100	
17	Kryeinfermier në repartin e alergologjisë. Kryeinfermierë në sterilizim. Kryemami në izolim		2%	0	35.200		
18	Laborant radiolog në onkologji		2%	0	31.000	3700	
19	Laborant rrezatim kobalti		2%	0	31.000	3400	
20	Laborant në mjekësinë bërthamore		2%	0	31.000	2650	
21	Infermierë në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale. Infermierë në sallën e operacionit		2%	0	31.000	2100	
22	Kryeinfermier reparti pranim urgjence. Laborant klinik biokimik. Infermier në punktin e gjakut. Infermier në hematologji. Infermier në onkologji. Infermiere endoskopie. Infermier/laborant bakteriolog, imunolog		2%	0	31.000	1800	
23	Infermier reparti radiologjik. Laborant radiolog. Kryeinfermiere (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji). Kryemami në qendrën e gruas		2%	0	31.000	1500	
24	Infermier/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obstetrike). Instrumentarë		2%	0	31.000	1100	
25	Kryeinfermierë neonatologji. Kryemami pranimi. Kryeinfermiere në kabinetin e dializës. Kryemami /Kryeinfermierë reparti. Kryeinfermierë konsultash në sëmundjet e brendshme. Kryelaborant bakteriolog, imunolog, ortopedi stomatologjike) Infermierë sterilizimi		2%	0	31.000		
26	Infermierë pavijoni rrezatimi		2%	0	30.000	3310	
27	Infermierë në shërbimin infektiv në QSUT		2%	0	30.000	8000	
28	Infermierë (infektiv),pranim urgjence, njësia e koordinimit të urgjencës)		2%	0	30.000	1800	
29	Ndihmës farmacist. Infermierë në hemodializë		2%	0	30.000	1500	



30	Infermier fizioterapi		2%	0	30.000	1100	
31	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji). Kryeinfermierë çerdhe për personelin. Infermier. Infermier çerdhe për personelin. Kujdestar në pediatri		2%	0	30.000		
32	Kujdestar në psikiatri		2%	0	26.400	5000	

LIDHJA 2 (KREU 2.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË
RAJONALE DHE VENDORE TË SHËNDETIT PUBLIK DHE NË AUTORITETIN
SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i Sektorit të Kujdesjeve Infermierore		2%	0	37.400		Nga..deri ...Lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermierore Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	35.200		
3	Ndihmës inspektor sanitar, ndihmëshigjienist, ndihmës epidemiolog Laborantë toksikologë Laborant bakteriolog/klinik biokimik		2%	0	31.000	1100	
4	Infermierë në shërbimet e shëndetit mendor		2%	0	31.000	5000	
5	Infermierë (hematologji, onkologji) Laborant rëntgeni		2%	0	31.000	1500	
6	Infermier statistike		2%	0	30.000		
7	Infermier ortopedi Infermier/laborant në fizioterapi		2%	0	30.000	1100	
8	Kryeinfermier/kryemami Infermier në shërbimin stomatologjik Ndihmës dentist		2%	0	30.000		
9	Ndihmës bakteriolog Infermier/mami		2%	0	26.400		



LIDHJA 2 (KREU 2.3)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË SPITALET E
RRETHEVE, QENDRËN E MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE REHABILITIMIT TË
FËMIJËVE TIRANË, DHE INFERMIERËT CIVILË NË STRUKTURAT E TJERA TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike		2%	0	37.400	6000	Nga...deri ...lekë
2	Kryeinfermier reparti në spitale psikiatrike		2%	0	37.400	5000	
3	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	37.400	1100	
4	Laborant në Anatominë Patologjike		2%	0	35.200	3400	
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakteriologjik Kryeinfermier (kirurgji, reanimacion, sallë operacioni, obstetrikë gjinekologji)		2%	0	35.200	1100	
6	Kryeinfermier		2%	0	35.200		
7	Infermiere në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	31.000	5000	
8	Infermiere reanimacioni Ndihmës anesteziistë Ndihmës farmacistë Laborant radiologjie Infermiere në radiologji Instrumentare Infermiere në hemodializë		2%	0	30.000	1500	
9	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit. Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanseri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obstetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatri, onkologji, dispanseri). Infermierë në repartin e lindjes. Infermier/laborant në Bankën e Gjakut, Hematologji Infermier/laborant në Bankën e Gjakut, Hematologji Përgjegjës turni		2%	0	30.000	1100	
10	Kryeinfermiere në Qendrën e Sterilizimit. Infermier pranim urgjence Laborant klinik biokimik /bakteriologjik		2%	0	30.000	600	
11	Infermier		2%	0	30.000		
12	Kujdestar në Psikiatri		2%	0	26.400	5000	
13	Kujdestar në Pediatri Ndihmës infermier		2%	0	26.400		



LIDHJA 2 (KREU 2.4)
STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË AGJENCINË KOMBËTARE TË
BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant		2%	0	36.300		Nga ... deri ...lekë

LIDHJA 2 (KREU 2.5)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË KLINIKËN E
SHËRBIMEVE MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier		2%	0	37.400		Nga...deri ...Lekë.
2	Infermier. Ndihmësstomatologë		2%	0	30.000		

LIDHJA 2 (KREU 2.6)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier/Kryelaborant		2%	0	35.200		Nga ... deri ...lekë
2	Infermier. Laborant		2%	0	30.000	1100	



LIDHJA 2 (KREU 2.7)
STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN
KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermier urgjence		2%	0	37.400	2000	Nga...deri ...lekë
2.	Infermier urgjence		2%	0	35.200	2000	Nga...deri ...lekë

LIDHJA 2 (KREU 2.8)
STRUKTURA E PAGAVE PËR TEKNIKËT NË NJËSITË E HELIKOPTERËVE TË
TRANSPORTIT MJEKËSOR TË SHËNDETËSISË, NË STRUKTURAT E MINISTRISË SË
MBROJTJES

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik		2%	0	35.200		Nga...deri ...lekë

LIDHJA NR. 3
VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

GRUPI	Lloji i diplomës	PAGA NË LEKË
1	Master i Shkencave. Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14000
2	Master Profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11000
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10000
4	Diplomë e shkollës së mesme për personelin infermior, lidhja 2 (kreu 2.1–2.8)	8000
5	Dëftesë lirimi (arsimi 8/9-vjeçar) dhe kurse infermierie, për personelin infermior, lidhja 2 (kreu 2.1–2.8).	6000



LIDHJA NR. 4
TITULLI

KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	PAGA (LEKË/MUAJ)
Shef shërbimi nga kategoria “Profesor”	123.800
Shef shërbimi nga kategoria “Docent”	106.700
Profesor	121.000
Profesor i asociuar	105.200
Docent	95.800

LIDHJA NR. 5
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT ME TITUJ
AKADEMIKË, NË INSTITUTIN E SHËNDETTIT PUBLIK

Nr rendor	Pozicioni	Paga
1.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria “Profesor”	130.500
2.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria “Docent”/”Doktor”	123.800
3.	Përgjegjës i Njesisë bazë nga kategoria “Profesor”	123.800
4.	“Përgjegjës i Njesisë bazë nga kategoria Docent/Doktor	106.700
5.	“Përgjegjës sektori nga kategoria “Profesor”.	123.800
6.	“Përgjegjës sektori nga kategoria “Docent/Doktor	106.700
7.	Profesor	121.000
8.	Profesor i Asociuar	105.200
9.	Docent (Doktor)	95.800
10.	Docent (Master)	91.800
11.	Kërkues i parë	90.300
12.	Kërkues.	73.400

LIDHJA NR. 6
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E TJERË ME ARSIM TË
LARTË NË INSTITUTIN E SHËNDETTIT PUBLIK

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
	1	2	3	4	5	6
1.	Titullar institucioni	II-a	1	2%	0	118100
2.	Zëvendëstitullar ekonomik	III-a	1	2%	0	80800
3.	Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet. Drejtor i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse	III-a	1	2%	0	80800
4.	Përgjegjës sektori në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada	III-a/1	1	2%	0	70500
5.	Përgjegjës sektori mbështetës	III-b	1	2%	0	61000
6.	Specialist në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	0	49000
7.	Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	38000



LIDHJA NR. 7
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E LABORATORIT NË
INSTITUTIN E SHËNDETTIT PUBLIK

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant mikrobiologji teknike laborator/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive.		2%	0	30.000	8000	Nga...deri ...lekë
2	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.		2%	0	31.000	3700	Nga...deri ...lekë

VENDIM

Nr. 189, datë 15.3.2017

**PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHETIT, TË STUDENTËVE DHE TË
KURSANTËVE NË INSTITUCIONET
ARSIMORE TË POLICISË SË SHETIT, SI
DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR OSE
TË ARRESTUAR, DERI NË SQARIMIN
E POZITËS SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtohen me ushqim, pa pagesë, strukturat e Policisë së Shtetit, si më poshtë:

a) Punonjësit e strukturave të veçanta të Policisë së Shtetit, ato të Forcave Speciale e të Ndërhijes së Shpejtë, si dhe struktura të tjera që me akte normative njehsohen me to:

i) me një vakt “drekë”, për ditët kur kohëzgjatja e punës është 8 (tetë) orë;

ii) me tri vakte për ditët kur punonjësit janë të angazhuar në veprime operationale apo gatishmëri, kur kohëzgjatja e punës është më shumë se koha normale e punës prej 8 (tetë) orësh;

iii) me tri vakte për ditët kur punonjësit e policisë janë të angazhuar në gatishmëri, në shërbime për ruajtjen, sigurimin dhe mbarrëvajtjen e

procesit zgjedhor, për përballimin e situatave emergjente dhe të fatkeqësive natyrore, të shkaktuara nga faktorë natyrorë, teknologjikë, industrialë, socialë ose veprime të shkaktuara nga njerëzit, kur kohëzgjatja e punës është mbi kohën normale të punës prej 8 (tetë) orësh.

b) Të gjithë studentët, kursantët dhe instruktorët në institucionet arsimore dhe në institucionet e Policisë së Shtetit brenda vendit:

i) me një vakt “drekë”, kur kohëzgjatja e trajnimit është 1 (një) ditë pune, 8 (tetë) orë;

ii) me tri vakte, kur kohëzgjatja e trajnimit është më shumë se një ditë pune. Për ditën e parë të trajnimit, trajtimi me ushqim do të bëhet për vaktet “drekë” e “darkë” dhe për ditën e fundit të trajnimit, trajtimi do të bëhet për vaktet “mëngjes” e “drekë”.

c) Trajtohen me tri vakte ushqim, pa pagesë, edhe kategoritë e mëposhtme:

i) shtetasit e huaj që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

ii) shtetasit shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

iii) shtetasit e ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre ose deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).

2. Normat e ushqimit ditor të k/kalorive për të gjitha strukturat përfituese të përmendura në pikat e mësipërme të këtij vendimi përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Punëve të



Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë, ku përcaktohen:

a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësisë ushqimore;

b) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.

3. Shërbimi i ushqimit bëhet i gatuar në mensa, si dhe me shërbim shpërndarjeje (*catering*), i cili i nënshtrohet të gjitha procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për rastet kur kategoritë përfituese sipas pikës 1.1, të këtij vendimi, për shkak të detyrës janë larg qendrës së punës e të shërbimit dhe kur shërbimi i shpërndarjes (*catering*) nuk mund të realizojë furnizimin me ushqim në atë terren, bëhet kompensimi në vlerë (në lekë), për ditët efektive të punës. Vlera e kompensimit (në lekë) të ushqimit bëhet bazuar në normën e përcaktuar ushqimore dhe miratohet nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

5. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim planifikohet për çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

6. Vendimi nr. 702, datë 21.8.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Gardës së Republikës, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkolla të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre”, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit, studentët dhe kursantët në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe për shtetasit e ndaluar apo të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 190, datë 15.3.2017

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE MOLLAS, TË
PRONËS ME NUMËR PASURIE 321, NË
ZONËN KADASTRALE 2691, ME
SIPËRFAQE 19350 m², DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1087,
DATË 23.7.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
NË KOMUNËN MOLLAS, TË QARKUT
TË KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, në njësinë administrative Mollas, të pronës me numër pasurie 321, e ndodhur në zonën kadastrale 2691, me sipërfaqe 19 350 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) m², sipas planrilevimit dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve të ngurta dhe të varrezave publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1087, datë 23.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Bashkisë Kolonjë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Në vendimin nr. 1087, datë 23.7.2008, të Këshillit të Ministrave, në titull dhe kudo në përmbajtjen e tij, fjalët “...në komunën Mollas...” zëvendësohen me “...në njësinë administrative Mollas, Bashkia Kolonjë...”.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.





FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia : KOLONJE Supervizoi : Ganiart Emini Pergj. Kadastres Fusha e perdorimit te prones : Infrastruktura dhe sherbime publike.										
Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr.Indek- sti i Hartes	Nr. Pasuri- se	Lloji Pasurise	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Nderfese (m2)	Funkcioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni /Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni /Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2691 K-34-126- (199-B)	321	Sheshe + Truall	Fshati Milec	5000.0		Stacion Transferimi te mbetejeve te ngurta te Bashkise Kolonje	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	Ne kete prone do te ndertohet objekti "Stacioni i Transferimit te mbetejeve te ngurta te rrethit Kolonje.
2	2691 K-34-126- (199-B)	321	Sheshe + Truall	Fshati Milec	14 350.0		Infrastruktura dhe sherbime publike	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	



VENDIM

Nr. 191, datë 15.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI AGJENCISË PËR
ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL TË
GODINAVE DHE TRUALLIT
FUNKSIONAL TË TYRE, NDODHUR NË
ZONËN KADASTRALE 8210, ME NUMËR
PASURIE 3/74, ME SIPËRFAQE 5 044.85 m²,
DHE ME NUMËR PASURIE 3/183, ME
SIPËRFAQE 1 580.89 m²**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5 044.85 (pesë mijë e dyzet e katër pikë tetëdhjetë e pesë) m² dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1 580.89 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë pikë tetëdhjetë e nëntë) m², sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, me qëllim zhvillimin e projektit “Qendra multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja “Betahaus Tërana””.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**VENDIM****Nr. 194, datë 15.3.2017****PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 18,
DATË 13.1.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E
PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË
DISA MJEDISEVE, NGA MINISTRIA E
BRENDSHME AUTORITETIT
KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 13.1.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa ambienteve, nga Ministria e Brendshme Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 196, datë 15.3.2017****PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE,
FORMAVE, KRITEREVE DHE
RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E
LOJËRAVE TË FATIT PROMOCIONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 5, e 70, pika 5, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. FORMAT DHE RREGULLAT PËR
ORGANIZIMIN E LOJËRAVE TË FATIT
PROMOCIONALE**

1. Lojërat e fatit promocionale mund të organizohen nga subjekte publike ose private, të cilat kërkojnë të promovojnë produkte apo shërbime të biznesit/veprimtarisë së tyre, duke i ofruar fituesit të lojës një çmim/bonus të caktuar në mjete monetare ose në ndonjë formë tjetër shpërblimi.

2. Subjekteve, të cilat kanë objekt të veprimtarisë së tyre organizimin e lojërave të fatit, nuk u lejohet të organizojnë lojëra fati promocionale.

3. Për të siguruar pjesëmarrjen në lojë, në varësi të formës së organizimit të lojës së fatit promocionale, personat e interesuar mund të parapagujnë një shumë të caktuar në mjete monetare ose në ndonjë formë tjetër pagese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

4. Lojërat e fatit promocionale mund të organizohen nga organizatorët nëpërmjet formave të mëposhtme:

a) Duke ofruar falas produktin/shërbimin që do të promovohet;

b) Duke ofruar produktin/shërbimin me çmimin e shitjes. Produkti mund të shoqërohet edhe me:

i) një kupon;

ii) një biletë;

iii) mundësinë për të gërvishtur në ambalazhin e produktit të blerë;

iv) çdo mënyrë tjetër, të parashikuar nga organizatori, por pa kosto të tjera shtesë për klientin.

5. Pas përfundimit të lojës, organizatori shpall fituesit, të cilët shpërblehen me produkte në vlerë monetare ose shërbime.

6. Subjektet publike apo private mund të organizojnë lojë fati promocionale, vetëm pasi të jenë pajisur me autorizimin përkatës nga drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

7. Për lojërat e fatit promocionale jepet autorizimi i posaçëm. Autorizimi është i vlefshëm nga data e fillimit të lojës e cila nuk duhet të fillojë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së autorizimit dhe vlen vetëm për një lloj të caktuar loje promocionale.



8. Kohëzgjatja e lojës promociionale përcaktohet me autorizim, bazuar në kërkesën e organizatorit të lojës, dhe miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (këtu e më poshtë referuar si AMLF), në varësi të llojit dhe formës së lojës promociionale, që do të organizohet.

9. Për marrjen e autorizimit, subjekti duhet të paraqesë pranë AMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim, ku të evidentohen të dhënat e subjektit, objekti i veprimtarisë së tij dhe një përshkrim i shkurtër i lojës, që do të organizohet;

b) Ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku të vërtetohet se shoqëria është me status aktiv;

c) Vërtetim që shoqëria nuk është në procedura likuidimi dhe/ose falimentimi;

ç) Certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit;

d) Vërtetim nga organi tatimor për shlyerjen e detyrimeve tatimore;

dh) Rregulloren në të cilën të jenë të parashikuara në mënyrë të detajuar mënyra e organizimit të lojës promociionale, kriteret që duhet të plotësojnë fituesit dhe çdo element tjetër që gjykohet i nevojshëm nga organizatori.

Përveç certifikatës së regjistrimit me NIUS-in, kriteret e sipërpërmendura vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e miratimit/lëshimit të tyre nga organet përgjegjëse shtetërore dhe që duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara.

10. Pas miratimit, AMLF-ja i përcjell një kopje të autorizimit organit tatimor, në juridiksionin e të cilit ndodhet subjekti organizator i lojës promociionale.

11. AMLF-ja merr në shqyrtim dhe vendos miratimin ose refuzimin e autorizimit brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës së subjektit pranë AMLF-së.

12. Në rast mosplotësimi të njërit prej kushteve për pajisjen me autorizim sipas pikës 9, të këtij kreu, AMLF-ja vendos refuzimin e autorizimit, duke dhënë dhe arsyet përkatëse për këtë vendim.

13. Përveç sa më sipër, subjektet tregtare që organizojnë lojëra fati promociionale zbatojnë dispozitat e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar, lidhur me ndalimin e praktikave tregtare të padrejta, të lidhura me kategorinë e lojërave të fatit promociionale.

II. MËNYRA DHE KRITERET E ORGANIZIMIT TË LOJËRAVE TË FATIT PROMOCIONALE

1. Mënyra e organizimit të lojës promociionale përcaktohet nga organizatori në rregulloren e lojës.

2. Kriteret, që duhet të plotësojë pjesëmarrësi në lojë, përcaktohen nga organizatori në rregulloren e lojës.

3. Rregullorja e lojës duhet të përmbajë këto të dhëna të detyrueshme për:

a) llojin e lojës promociionale, që do të organizohet;

b) kohëzgjatjen e lojës, sipas parashikimit të organizatorit;

c) numrin dhe mënyrën e shpërblimit të fituesve;

ç) vlerën monetare/çmimin, me dhe pa TVSH, që duhet të paguajë pjesëmarrësi në lojë, apo format e tjera të pagesës, në varësi të mënyrës së organizimit të lojës, në përputhje me përcaktimin e shkronjave “a” e “b”, të kësaj pike;

d) çmimin/bonusin që ofron organizatori i lojës, të konvertuar edhe në vlerë monetare;

dh) numrin e parashikuar të pjesëmarrësve në lojë;

e) pjesëmarrësit që kanë të drejtë të marrin pjesë në lojë;

ë) mënyrën e përzgjedhjes së fituesve dhe vendin ku do të bëhet përzgjedhja;

f) mënyrën e njofimit të fituesve;

g) informacion të plotë dhe të saktë lidhur me mekanizmin e lojës promociionale.

Organizatori mund të përfshijë në rregullore çdo të dhënë tjetër që vlerësohet e nevojshme nga ana e tij.

4. Pjesëmarrësit në lojë duhet të jenë persona të identifikueshëm nga organizatori i lojës dhe detyrohen që në çastin e marrjes së çmimit të paraqesin pranë organizatorit të lojës dokumentin identifikues, kartë identiteti ose pasaportë.

5. Për kategoritë e lojërave promociionale, të përcaktuara më poshtë, organizatori, në varësi të llojit të lojës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Për lojën promociionale me anë të mesazheve (SMS), organizatori duhet të deklarojë për pjesëmarrësit në lojë informacionin e mëposhtëm:

i) Koston e një mesazhi telefonik, me ose pa TVSH, e cila nuk mund të kalojë vlerën 100 (njëqind) lekë me TVSH;



- ii) numrin, ku duhet të dërgohet mesazhi;
- iii) operatorin, që do të ofrojë shërbimin.

b) Për lojën promocionale me telefonata, organizatori duhet të deklarojë për pjesëmarrësit në lojë informacionin e mëposhtëm:

i) koston e një telefonate, me ose pa TVSH, e cila nuk mund të jetë më e lartë se 200 (dyqind) lekë/telefonata, pa TVSH;

- ii) numrin, ku duhet të dërgohet;
- iii) operatorin, që ofron shërbimin.

Të dhënat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, janë pjesë e rregullores së lojës.

c) Fituesit e çmimeve të ofruara përzgjidhen sipas mënyrës/ave, që detyrimisht përmbajnë elementin rastësor.

ç) Për marrjen e autorizimit, subjekti duhet të paguajë paraprakisht tarifën prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh. Në rast refuzimi të autorizimit, shuma e paguar është e kthyeshme nga AMLF-ja, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e refuzimit të autorizimit.

Të ardhurat nga tarifa e pajisjes me autorizim për lojë promocionale fati derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit.

d) Çmimi/bonusi i ofruar nga organizatori i lojës së fatit, i konvertuar në vlerë monetare, nuk duhet të jetë më i vogël se 80 për qind e shumës së akumuluar prej pjesëmarrësve në lojë për lojërat e organizuara nëpërmjet mesazheve (SMS) apo të telefonatave.

dh) Për tipat e tjerë të lojërave promocionale, organizatori duhet të deklarojë në rregulloren e lojës së fatit çmimin, që do të ofrojë, të konvertuar edhe në vlerë monetare.

e) Tërheqja e çmimit bëhet në kohën, vendin dhe mënyrën e publikuar nga organizatori. Në çastin e hedhjes së shorteut dhe ndarjes së çmimeve merr pjesë një përfaqësues nga AMLF-ja dhe një përfaqësues nga organi tatimor, ku subjekti është i regjistruar, të cilët mbajnë procesverbalin përkatës dhe e depozitojnë në institucionin të cilin përfaqësojnë.

ë) Organizatori i lojës, 20 (njëzet) ditë përpara datës së ndarjes së çmimeve, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe organit tatimor ku subjekti është i regjistruar njoftimin për datën dhe orën e ndarjes së çmimeve.

f) Titullarët e organeve të parashikuara në pikën 10, të këtij kreu, pajisin me autorizim përfaqësuesit

e tyre për të asistuar në ndarjen e çmimeve. Në rast mosparaqitjeje pa shkaqe të arsyeshme të përfaqësuesve të autorizuar gjatë ndarjes së çmimeve në rast depozitimi të kërkesës, organizatori informon titullarin e organit përkatës dhe vijon me procesin e ndarjes së çmimeve.

g) Në rast se organizatori kryen ndarjen e çmimeve pa njoftuar organet e parashikuara në pikën 10, të këtij kreu, organizatorit i hiqet e drejta për pajisje me autorizim, për një periudhë 3-vjeçare, pas përfundimit të afatit të autorizimit të lëshuar.

gj) Organizatori i lojës duhet të ruajë, për një periudhë jo më pak se 6 (gjashtë) vjet nga data e përfundimit të lojës, të gjithë dokumentacionin e përdorur për organizimin e lojës promocionale të fatit, konkretisht, por pa u kufizuar në: mënyrën e zhvillimit të lojës, numrin e pjesëmarrësve, çmimet e shpërndara, emrat dhe adresat e fituesve.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit raporton pranë ministrit të Financave brenda tremujorit të parë të çdo viti dhe sa herë që kërkohet prej tij për çështjet e lidhura me zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, strukturat e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtorive rajonale tatimore dhe organizatorët e lojërave të fatit promocionale për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 770, datë 15.7.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrave, të formave, kriterëve dhe të rregullave shtesë për organizimin e lojërave të fatit promocionale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 197, datë 15.3.2017

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2018–2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për



menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018–2020, sipas lidhjes nr. 1, “Tavanet e

ministrive dhe të institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr.1

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, në milion Lekë

	viti 2018										viti 2019										viti 2020																	
	600-601		602-606		230-231		Paga/Liq./Shoq.		Te tjera Korente		Investime/ brendshme		Investime/ hula		Total		Paga/Liq./Shoq.		Te tjera Korente		Investime/ brendshme		Investime/ hula		Total		Paga/Liq./Shoq.		Te tjera Korente		Investime/ brendshme		Investime/ hula		Total			
	99	100	6	0	0	0	200	0	0	0	0	0	0	0	200	0	99	100	6	0	0	0	0	0	0	0	200	0	99	100	6	0	0	0	200	0		
1. Presidencia	609	454	48	0	0	0	1,111	609	454	48	0	0	0	0	1,111	609	454	48	0	0	0	0	0	0	0	0	1,111	609	454	48	0	0	0	0	1,111	609		
2. Kuvendi	690	1,885	754	550	0	0	3,979	690	1,885	754	550	0	0	0	3,979	690	1,885	754	550	0	0	0	0	0	0	0	3,979	690	1,885	754	550	0	0	0	0	3,979	690	
3. Kryeministria	971	437	324	600	0	0	1,932	971	437	324	600	0	0	0	1,932	971	437	324	600	0	0	0	0	0	0	0	1,932	971	437	324	600	0	0	0	0	1,932	971	
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sigurimeve	1,646	3,309	2,880	2,085	0	0	8,920	1,646	3,309	2,880	2,085	0	0	0	8,920	1,646	3,309	2,880	2,085	0	0	0	0	0	0	0	8,920	1,646	3,309	2,880	2,085	0	0	0	0	8,920	1,646	
5. Ministria e Bujësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	419	3,423	14,662	19,364	0	0	38,068	419	3,423	14,662	19,364	0	0	0	38,068	419	3,423	14,662	19,364	0	0	0	0	0	0	0	38,068	419	3,423	14,662	19,364	0	0	0	0	38,068	419	
6. Ministria e Transportit dhe Infrastruktura	3,482	3,222	500	700	0	0	7,854	3,482	3,222	500	700	0	0	0	7,854	3,482	3,222	500	700	0	0	0	0	0	0	0	7,854	3,482	3,222	500	700	0	0	0	0	7,854	3,482	
10. Ministria e Financave	23,773	9,544	2,834	300	0	0	36,451	23,773	9,544	2,834	300	0	0	0	36,451	23,773	9,544	2,834	300	0	0	0	0	0	0	0	36,451	23,773	9,544	2,834	300	0	0	0	0	36,451	23,773	
11. Ministria e Arsimit dhe Sportit	865	423	450	0	0	0	1,738	865	423	450	0	0	0	0	1,738	865	423	450	0	0	0	0	0	0	0	0	1,738	865	423	450	0	0	0	0	0	1,738	865	
12. Ministria e Kulturës	2,471	2,691	1,075	1,140	0	0	27,094	2,471	2,691	1,075	1,140	0	0	0	27,094	2,471	2,691	1,075	1,140	0	0	0	0	0	0	0	27,094	2,471	2,691	1,075	1,140	0	0	0	0	27,094	2,471	
13. Ministria e Shëndetësisë	4,126	2,022	310	0	0	0	1,860	4,126	2,022	310	0	0	0	0	1,860	4,126	2,022	310	0	0	0	0	0	0	0	0	1,860	4,126	2,022	310	0	0	0	0	0	1,860	4,126	
14. Ministria e Drejtësisë	858	1,120	60	0	0	0	2,438	858	1,120	60	0	0	0	0	2,438	858	1,120	60	0	0	0	0	0	0	0	0	2,438	858	1,120	60	0	0	0	0	0	2,438	858	
15. Ministria e Punëve të Jashtme	13,902	4,165	1,100	897	0	0	20,064	13,902	4,165	1,100	897	0	0	0	20,064	13,902	4,165	1,100	897	0	0	0	0	0	0	0	20,064	13,902	4,165	1,100	897	0	0	0	0	20,064	13,902	
16. Ministria e Brendshme	6,504	5,051	1,350	0	0	0	13,455	6,504	5,051	1,350	0	0	0	0	13,455	6,504	5,051	1,350	0	0	0	0	0	0	0	0	13,455	6,504	5,051	1,350	0	0	0	0	0	13,455	6,504	
17. Ministria e Mbrojtjes	975	442	50	0	0	0	1,467	975	442	50	0	0	0	0	1,467	975	442	50	0	0	0	0	0	0	0	0	1,467	975	442	50	0	0	0	0	0	1,467	975	
18. Shërbimi Informativ Shtetëror	0	965	0	0	0	0	965	0	965	0	0	0	0	0	965	0	965	0	0	0	0	0	0	0	0	0	965	0	965	0	0	0	0	0	0	965	0	
19. Drejtoria e Radio Televizionit	124	84	5	0	0	0	163	124	84	5	0	0	0	0	163	124	84	5	0	0	0	0	0	0	0	0	163	124	84	5	0	0	0	0	0	163	124	
20. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	32	77	2	0	0	0	111	32	77	2	0	0	0	0	111	32	77	2	0	0	0	0	0	0	0	0	111	32	77	2	0	0	0	0	0	111	32	
22. Akademia e Shkencës	269	91	20	0	0	0	380	269	91	20	0	0	0	0	380	269	91	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	380	269	91	20	0	0	0	0	0	380	269
24. Kontrolli Lartë i Shëtit	2,295	25,352	602	834	49,409	0	78,482	2,295	25,352	602	834	49,409	0	0	78,482	2,295	25,352	602	834	49,409	0	0	0	0	0	0	78,482	2,295	25,352	602	834	49,409	0	0	0	0	78,482	2,295
25. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	725	267	1,615	690	0	0	3,297	725	267	1,615	690	0	0	0	3,297	725	267	1,615	690	0	0	0	0	0	0	0	3,297	725	267	1,615	690	0	0	0	0	3,297	725	
26. Ministria e Mbrojtjes	1,185	349	130	0	0	0	1,664	1,185	349	130	0	0	0	0	1,664	1,185	349	130	0	0	0	0	0	0	0	0	1,664	1,185	349	130	0	0	0	0	0	1,664	1,185	
28. Prokuroria e Përgjithshme	1,634	362	160	0	0	0	2,156	1,634	362	160	0	0	0	0	2,156	1,634	362	160	0	0	0	0	0	0	0	0	2,156	1,634	362	160	0	0	0	0	0	2,156	1,634	
29. Zyra e Administrimit Buxhetor Gjyqësor	80	31	4	0	0	0	115	80	31	4	0	0	0	0	115	80	31	4	0	0	0	0	0	0	0	0	115	80	31	4	0	0	0	0	0	115	80	
30. Gjykata Kushtetuese	40	13	1	0	0	0	54	40	13	1	0	0	0	0	54	40	13	1	0	0	0	0	0	0	0	0	54	40	13	1	0	0	0	0	0	54	40	
41. Agjencia Telegrafike Shqiptare	0	200	0	0	0	0	200	0	200	0	0	0	0	0	200	0	200	0	0	0	0	0	0	0	0	0	200	0	200	0	0	0	0	0	0	200	0	
50. Partia Politike	304	88	7	0	0	0	399	304	88	7	0	0	0	0	399	304	88	7	0	0	0	0	0	0	0	0	399	304	88	7	0	0	0	0	0	399	304	
50. Institutit Statistikës	37	52	1	0	0	0	90	37	52	1	0	0	0	0	90	37	52	1	0	0	0	0	0	0	0	0	90	37	52	1	0	0	0	0	0	90	37	
55. Shkolla e Magistraturës	0	0	4,938	5,000	0	0	10,238	0	0	4,938	5,000	0	0	0	10,238	0	0	4,938	5,000	0	0	0	0	0	0	0	10,238	0	0	4,938	5,000	0	0	0	0	10,238	0	
56. Fondi i Zhvillimit Shqiptar	9	153	2	0	0	0	164	9	153	2	0	0	0	0	164	9	153	2	0	0	0	0	0	0	0	0	164	9	153	2	0	0	0	0	0	164	9	
57. Qendra Kombëtare e Krimnologjisë	64	28	2	0	0	0	94	64	28	2	0	0	0	0	94	64	28	2	0	0	0	0	0	0	0	0	94	64	28	2	0	0	0	0	0	94	64	
63. Këshilli i Lartë i Drejtësisë	85	17	4	0	0	0	106	85	17	4	0	0	0	0	106	85	17	4	0	0	0	0	0	0	0	0	106	85	17	4	0	0	0	0	0	106	85	
66. Avokati i Popullit	37	13	4	0	0	0	54	37	13	4	0	0	0	0	54	37	13	4	0	0	0	0	0	0	0	0	54	37	13	4	0	0	0	0	0	54	37	
67. Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	74	33	3	0	0	0	110	74	33	3	0	0	0	0	110	74	33	3	0	0	0	0	0	0	0	0	110	74	33	3	0	0	0	0	0	110	74	
73. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	105	17	3	0	0	0	125	105	17	3	0	0	0	0	125	105	17	3	0	0	0	0	0	0	0	0	125	105	17	3	0	0	0	0	0	125	105	
76. Inspektorati i Konkurrencës	53	11	1	0	0	0	64	53	11	1	0	0	0	0	64	53	11	1	0	0	0	0	0	0	0	0	64	53	11	1	0	0	0	0	0	64	53	
77. Autoriteti i Konkurrencës	7	4	1	0	0	0	12	7	4	1	0	0	0	0	12	7	4	1	0	0	0	0	0	0	0	0	12	7	4	1	0	0	0	0	0	12	7	
78. Ministria e Integritetit	112	74	43	220	0	0	449	112	74	43	220	0	0	0	449	112	74	43	220	0	0	0	0	0	0	0	449	112	74	43	220	0	0	0	0	0	449	112
82. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	7	0	0	0	0	0	7	7	0	0	0	0	0	0	7	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	7	0	0	0	0	0	0	0	7	7	
87. Institucione të tjera Qeveritare	308	263	148	0	0	0	719	308	263	148	0	0	0	0	719	308	263	148	0	0	0	0	0	0	0	0	719	308	263	148	0	0	0	0	0	719	308	
90. Mbrojtësit për Shqiptarë Civilë	44	19	1	0	0	0	64	44	19	1	0	0	0	0	64	44	19	1	0	0	0	0	0	0	0	0	64	44	19	1	0	0	0	0	0	64	44	
95. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	28	10	1	0	0	0	39	28	11	1	0	0	0	0	39	28	11	1	0	0	0	0	0	0	0	0	39	28	11	1	0	0						

**VENDIM****Nr. 198, datë 15.3.2017**

**PËR DISA SHTESA NË NUMRIN
E PUNONJËSVE PËR MINISTRINË
E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS DHE MINISTRINË
E ENERGJISË DHE INDUSTRIË,
PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës shtohet me 15 veta dhe bëhet 448 punonjës.

2. Numri i punonjësve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë shtohet me 10 veta dhe bëhet 437 punonjës.

3. Numri i punonjësve rezervë, i parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit, reduktohet me 25 veta, duke e çuar numrin rezervë të punonjësve në 0.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 199, datë 15.3.2017**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E
TRAJTIMIT TË KREDIVE TE MINISTRIA
E FINANCIVE, PËR DEGËN E
THESARIT SARANDË, TË NJË
AMBIENTI NË PRONËN NR. 13/125-M7,
NË ZONËN KADASTRALE 8641, ME
VENDNDODHJE NË ADRESËN “LAGJJA
NR. 1”, NË QYTETIN E SARANDËS, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 513, DATË 15.8.2007, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
FINANCIVE PËR AGJENCINË E
TRAJTIMIT TË KREDIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive të Ministria e Financave, për Degën e Thesarit Sarandë, të një ambienti me sipërfaqe 25 m², me numër pasurie 13/125-M7, në zonën kadastrale 8641, me vendndodhje në adresën “Lagjja nr. 1”, në qytetin e Sarandës, sipas planvendosjes dhe hartës treguese që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit e miratuar me vendimin nr. 513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Kredive dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**





HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

S A R A N D E

REGJISTRUESE

Adriana SHEHU

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

13/125-N7

ZONA KADASTRALE 8641 NR. I PASURISE VOL. 49 Fq. 179

INDEKSI I HARTES SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISE: Rrethi Sarandë Q/F Sarandë

Rr/L. P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. P.Nr 13/395

L. P.Nr 13/127

J. P.Nr 13/377

P. P.Nr 13/395

C. PRONARI / ET

Agjencia e Trajtitimit te Kredive

Ora: _____



**VENDIM****Nr. 200, datë 15.3.2017****PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA
MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja “b”, dhe 4, shkronja “b”, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a” dhe 2, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së niveleve të pagave për gradë dhe të shtesave mbi pagë për punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas strukturave në të cilat ushtrojnë funksionet policore, trajtimin financiar të kursantëve, të punonjësve të policisë që kryejnë kurse shkollimi/trajnimi, si dhe trajtimin financiar të bashkëpunëtorëve të institucioneve arsimore të sistemit policor.

2. Struktura dhe nivelet e pagave bazë për gradë për punonjësit e Policisë së Shtetit janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shtesat për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shtesat për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Shtesat për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit, janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Shtesat për natyrë të veçantë pune, për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e tjera policore, janë sipas lidhjes nr. 5, që

i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Punonjësit e Policisë së Shtetit, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Llogaritja e shtesës për vjetërsi bëhet mbi pagën e gradës “Inspektor”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura, Policisë së Burgjeve, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Gardës së Republikës, e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

8. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimi, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

9. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët e drejtorive”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional/Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Informatikë ekonomike”, “Inxhinieri telekomunikacioni” apo “Shkenca kompjuterike”, “Informatikë ekonomike” apo “Inxhinieri matematike informatike”, përfitojnë një shtesë mbi pagë në masën:

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë me baza të të dhënave shtetërore (si punonjësit analogë civilë pa status policor), në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, në nivel qendror;

- 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për punonjësit e Policisë së Shtetit që nuk punojnë me baza të të dhënave shtetërore (si punonjësit analogë civilë pa status policor), në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, në nivel qendror;



- 5 000 (pesëmijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të strukturave vendore të Policisë së Shtetit.

10. Punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në vende pune të vështira e të dëmshme për shëndetin përfitojnë shtesë mbi pagë. Masa e shtesës për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin përcaktohet sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Kursantët që pranohen në kolegjin profesional “Kolegji i Policisë”, në Akademinë e Sigurisë, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë trajtim me pagesë në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

12. Punonjësit e Policisë së Shtetit mund të trajnohen brenda ose jashtë vendit, në kuadër të programeve të trajnimeve, të parashikuara e të organizuara nga institucioni. Gjatë kohës që kryejnë kurse shkollimi apo trajnimi, brenda apo jashtë vendit, me iniciativën e institucionit, përfitojnë trajtim me pagesë, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Për periudhat e shkollimit/trajnitimit që zgjasin nga një deri në gjashtë muaj, gjatë periudhës së shkollimit/trajnitimit punonjësi përfiton pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit;

b) Për periudhat e shkollimit/trajnitimit që zgjasin më shumë se gjashtë muaj, gjatë periudhës së shkollimit/trajnitimit duke filluar nga muaji i shtatë e në vazhdim, punonjësit i ndërpritet paga dhe i jepet një kompensim, në varësi të pjesëtarëve të familjes që ka në ngarkim:

- punonjësi pa ose me një pjesëtar të familjes në ngarkim, përfiton 40% të pagës bazë mujore për grade, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit;

- punonjësi me më shumë se një pjesëtar të familjes në ngarkim, përfiton 50% të pagës bazë mujore për grade, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, pagesat apo kompensimet e punonjësit kryhen nga njësia buxhetore ku është efektiv punonjësi, përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit.

13. Në rastet kur punonjësi i policisë ka fituar një kurs shkollimi apo trajnimi në mënyrë individuale dhe jo me iniciativën e institucionit, gjatë kohës së shkollimit/trajnitimit nuk përfiton pagesë nga institucioni.

14. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që nuk është efektiv me kohë të plotë në institucionet e sistemit arsimor policor, por bashkëpunon me këto institucione si punonjës i jashtëm, për çdo orë mësimore 60-minutëshe, përfiton një pagë, si më poshtë vijon:

a) Në kurset e formimit bazë për punonjësit me gradë “Inspektor”, në masën 300 (treqind) lekë/për orë;

b) Në kurset e shkollimit/trajnitimit për punonjësit me gradë “Nënkomisar” deri në “Drejtnes i Parë”, në masën 500 (pesëqind) lekë/për orë.

15. Policia e Shtetit lejohet të përdorë fondin e pagave të planifikuar në programin vjetor buxhetor “Policia e Shtetit”, për shpërblimin e punonjësve të saj, në zbatim të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014.

16. Vendimi nr. 1135, datë 5.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

17. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LIDHJA NR. 1
PAGA BAZË PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHETËTIT

Grada	Paga bazë për gradë
Inspektor	50000
Nënkomisar	65500
Komisar	72000
Kryekomisar	87000
Drejtues	99000
Drejtues i parë	103000
Drejtues i lartë	115000
Drejtues madhor	125000

Lidhja nr. 2

Grada	Shitesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit e Policisë së Shetit në strukturat e luftës ndaj krimtë të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorist dhe në strukturat e policisë shkencore					
	Në funksione të drejtorisë të forcës së posaçme të sektorit të operacionale, oficerë të policisë gjyqësore pranë prokurorisë për krimet e rënda.	Në funksione të sektorit të hetimit nën mbulim në drejtorinë e forcës së posaçme të sektorit të operacionale.	Në funksione të sektorit të hetimit dhe koordinimit, njësitë për tendencat e radikalizimit dhe ekstremizmit në shtet dhe sektori i analizës dhe kartotekës, në drejtorinë e antiterrorit.	Në funksione të sektorit të zbatimit të masave mbrojtëse, të përpunimit të të dhënave dhe ndihmës dhe seksionit të planifikimit operacional dhe gjetshmërisë në drejtorinë e mbrojtjes së deshmilarëve.	Në funksione të analizës së kriminalit të analizës dhe kartotekës në policinë vendore, në funksionet e institutit të policisë shkencore.	Në funksione të hetimit e markotkeve dhe trafikeve, për hetimin e krimtë ekonomik e financiar, të analizës dhe informacionit kriminal në drejtorinë e përgjithshme për krimin e organizuar dhe krimet e rënda. Në funksionet e policisë shkencore në komisaritet e policisë dhe drejtoritë vendore të policisë. Në funksionet e policisë gjyqësore në drejtoritë vendore të policisë. Në funksionet e teknologjisë dhe përgjimit në policinë vendore dhe në sektorin e përgjimit të telekomunikimit.
Inspektor	15500	25000	11000	15000	7000	9000
Nënkomisar	15500	25000	11000	15000	7000	9000
Komisar	15500	25000	11000	15000	7000	9000
Kryekomisar	15500	25000	11000	15000	7000	9000
Drejtues	15500	25000	11000	15000	7000	9000
Drejtues i parë	15500	25000	11000	15000	7000	9000



Lidhja nr. 3

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike			
	Në funksionet e repartit special "RENEA" (komandant repartit, zv/komandant repartit, në strukturat operacionale, në funksionet e sektorit të planifikimit të stërvitjes dhe trajnimeve, në funksionet e njësive dhe seksioneve operacionale, komandant dhe zv/komandant njësie, shërbimi operacional dhe trupë operacionale), në funksionet e njësive speciale të negociimit dhe në funksionet e njësive speciale antieksplzivave.	Në strukturat e repartit special "RENEA" (komandant repartit, zv/komandant repartit, në strukturat operacionale, në funksionet e sektorit të planifikimit të stërvitjes dhe trajnimeve, në funksionet e njësive dhe seksioneve operacionale, komandant dhe zv/komandant njësie, shërbimi operacional dhe trupë operacionale), në funksionet e njësive speciale të negociimit dhe në funksionet e njësive speciale antieksplzivave.	Në funksionet e repartit special "RENEA" (komandant repartit, zv/komandant repartit, në strukturat operacionale, në funksionet e sektorit të planifikimit të stërvitjes dhe trajnimeve, në funksionet e njësive dhe seksioneve operacionale, komandant dhe zv/komandant njësie, shërbimi operacional dhe trupë operacionale), në funksionet e njësive speciale të negociimit dhe në funksionet e njësive speciale antieksplzivave.	Në funksione të ndërhjës së shpejtë, (komandant repartit, seksioni i operacioneve, seksioni i trajnimit dhe njësiti operacionale).
Inspektor	40000	15500	9000	6000
Nënkomisar	40000	15500	9000	6000
Komisar	40000	15500	9000	6000
Kryekomisar	40000	15500	9000	6000
Drejtuës	40000	15500	9000	6000
Drejtuës i parë	40000	15500	9000	6000



Lidhja nr. 4

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit			
	Në funksione: Komandant Reparti, zv/komandant dhe në funksionet e seksioneve të shërbimeve operacionale tokësore e detare, të Repartit Special të Kufirit dhe Migracionit "Delta".	Në funksione të hetimit për kufirin dhe migracionin	Në funksione të drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin, drejtor i qendrës së mbështetjes dhe shërbimeve për kufirin dhe migracionin.	Në funksione: të shërbimit të kufirit dhe migracionit, të kufirit, të migracionit, të imigracionit, në seksionin e prijës trajtimi dhe sigurisë në QMH, në stacionet e policisë kufitare. Në funksione: të sallave të operative, dhe sigurimit të objektit, shërbimi i qendrës nder institucionale operacionale detare, qendrat e shkëmbimit të informacionit, seksioni i sigurisë kufitare.
Inspektor	15000	7000		6000
Nënkomisar	15000	7000		6000
Komisar	15000	7000	9000	6000
Kryekomisar	15000	7000	9000	6000
Drejtuës	15000	7000	9000	6000
Drejtuës i parë		7000	9000	



Lidhja nr. 5

Shtesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e tjera policore						
Grada	Në funksione të: drejtorisë së menaxhimit të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave, të drejtorisë së standardëve profesionale, drejtorisë së BKNEP-së, shef sektori në aparatet e drejtorisë së policisë së shtetit dhe drejtorisë së policisë së shtetit dhe DTL, në funksione të drejtorisë së studimeve strategjike, në Akademinë e Sigurisë në funksionet e shkollimit fakultet dhe kolegj, në funksionet e certifikimeve, kërkimeve shkencore dhe planifikim kontrollit (drejtor, shef sektori, shef seksioni, përgjegjës departamenti, profesor, lektor, asistent/lektor, specialist, specialist/ instruktor, ndihmës specialist, specialist cepol).	Në funksione mbështetëse dhe administrative të sektorëve dhe seksioneve të strukturave qendrore dhe vendore të policisë së shtetit.	Në funksione drejtorie në varësi të drejtorit të policisë së shtetit dhe të drejtorit të përgjithshëm, shef i zyrës ndihmëse i drejtorit të Policisë së Shtetit.	Në funksione: Asistent zv/drejtorit të policisë, asistent i drejtorit të përgjithshëm, asistent në drejtorinë vendore të policisë dhe zëdhënës në drejtorinë vendore të policisë.	Në funksionin shëf sektori për komunikimin me median dhe publikum, në drejtorinë e policisë së shtetit, shëf sektori i sallës së komandimit në drejtorinë e përgjithshme për sigurinë publike.	Në funksione të: drejtorit të drejtorisë vendore Tiranë, drejtorit të përgjithshëm, zv/drejtorit të policisë së shtetit dhe drejtorit të policisë së shtetit.
Inspektor	6000	4000		7000		
Nënkomisar	6000	4000		7000		
Komisar	6000	4000		7000	9000	
Kryekomisar	6000	4000		7000	9000	
Drejtuës	6000	4000	15500	7000	9000	30000
Drejtuës i parë	6000	4000	15500	7000		30000
Drejtuës i lartë						30000
Drejtuës Madhor						40000



LIDHJA NR. 6
FUNKSIONET E PUNONJËSVE TË POLICISË QË PËRFITOJNË SHITESË PËR PUNË TË
VËSHTIRË E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN NË STRUKTURAT E POLICISË
SË SHETËTIT

Nr.	Emërtimi i funksionit	Emërtimi i strukturës policore	Masa e shtesës në lekë
I	Në strukturat e Policisë	Në Institutin e Policisë Shkencore	
1	Drejtor Shef sektori Specialist kriminalist Ndihmës specialist Laborant kriminalist Inspektor/ekspert Inspektor Ekspert	- Në Institutin e Policisë Shkencore - Në sektorin e përpunimit të gjurmëve papilare dhe vendit të ngjarjes. - Në sektorin e ekzaminimeve biologjike dhe AND-së. - Në sektorin e ekzaminimeve kimike. - Në sektorin e ekzaminimeve balistike.	12,000
2	Shef sektori Specialist Specialist kriminalist Ndihmës specialist Laborant kriminalist Specialist i administrimit të provave Laborant i administrimit të provave	- Në sektorin e kontrollit shkencor të cilësisë. - Në sektorin e gjurmëve të gishtave (daktiloskopia). - Në sektorin e ekzaminimeve grafike dhe dokumenteve. - Në sektorin e administrimit të provave dhe dokumentacionit.	10,600
3	Shef sektori Specialist kriminalist Inspektor Ekspert	Në sektorin e ekzaminimeve kompjuterike dhe audio – video.	5,300
4	Shef sektori Shef seksioni Specialist Ndihmës specialist laborant. Laborant. Specialist ekspert.	Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë: - Në sektorin e policisë shkencore. - Në seksionin për vendngjarjet dhe ekzaminimet. - Në sektorin e kartotekës e administrimit të provave Në Komisaritet e Policisë Tiranë - Në seksionin për krimet Në Drejtoritë Vendore të Policisë - Në sektorin e policisë shkencore Në Komisaritet e Policisë - Në seksionin e policisë shkencore - Në seksionin për krimet - Në seksionin për krimet e rënda dhe për krimet.	10,600
II		Në strukturat e trajtimit dhe magazinimit të lëndëve narkotike	
	Specialist për trajtimin e lëndëve narkotike Ndihmësspecialist për magazinën e narkotikëve	- Në Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda. - Në sektorin për hetimin e narkotikëve.	10,600
III		Në strukturat e përgjimit	



1	Shef sektori Specialist Oficer i policisë gjyqësore përgjimi SHISH Oficer i policisë gjyqësore zyra e Prokurorit të Përgjithshëm Ndihmës specialist për përgjimin ambienta operacional Ndihmës specialist depërtimi dhe kamuflimi Ndihmës specialist për hetimin Ndihmës specialist përgjimi në operacione speciale	- Në sektorin e përgjimit e telekomunikimit. - Në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale: - Në sektorin e hetimit nën mbulim dhe funksionet në sektorin e mbështetjes tekniko shkencore. - Në qendrën e drejtimit dhe menaxhimit të operacioneve speciale.	5,300
2	Shef seksioni Specialist për përgjimin dhe depërtimin Ndihmës specialist	Në drejtoritë vendore të Policisë Tiranë: - Në seksionin tekniko-shkencor dhe depërtimit.	5,300
3	Shef seksioni Specialist Ndihmës specialist. Specialist për teknologjinë dhe përgjimin Ndihmës specialist për teknologjinë dhe përgjimin	Në drejtoritë vendore të Policisë - në seksionin e teknologjisë dhe përgjimin - në Komisariatet e Policisë	5,300
IV		Në strukturat e trajtimit të eksploziveve dhe lëndëve të tjera plasëse:	
	Shef njësie. Specialist antieksplzivash në forcat speciale. Ndihmës specialist, në forcat speciale. Shoqërues qeni dhe shofer.	- Në njësinë speciale të antieksplzivave	9,300
V	Komandant njësie. Zëvendëskomandant njësie, trupë shërbimi operacional/zhytës. Trupë shërbimi operacional/zhytës dhe shofer. Shef seksioni. Specialist për shërbimet e kufirit blu. Përgjegjës grupi. Drejtues mjeti lundrues. Trupë shërbimi, motorist, Trupë shërbimi operator.	Zhytësit dhe punonjësit e shërbimeve operacionale detare: - Në njësinë speciale të zhytjes - Në shërbimet operacionale detare	1,500
VI	Në strukturat e policisë rrugore:		
	Shef njësie Specialist Trupë shërbimi ndihmës specialist Specialist për policinë rrugore, koordinator Shef seksioni Specialist shërbimi, përgjegjës Përgjegjës trupe shërbimi Ndihmës specialist Oficer i policisë gjyqësore Specialist Ekspert	Në njësinë operacionale për sigurinë rrugore. Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë - Në Komisariatin Rajonal të Policisë Rrugore - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në trafikun urban. - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në linja jashtë qytetit. - Në seksionin e verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës. - Në seksionin e hetimit të aksidenteve rrugore (OPGJ). - Në seksionin e verifikimit të aksidenteve rrugore (ekspertët/dëme materiale).	5,300



	Shef sektori Shef seksioni Specialist i hetimit të ngjarjeve në qarkullim Specialist shërbimi, përgjegjës grupi Përgjegjës grupi Trupë shërbimi Trupë shërbimi trafiku dhe linja në të gjitha strukturat e policisë rugore	Në drejtoritë vendore të Policisë: - Në sektorin e policisë rugore. - Në seksionin e hetimit të ngjarjeve në qarkullim dhe AIS. Në komisaritet e Policisë: - Në seksionin e kontrollit dhe menaxhimit të qarkullimit rrugor.	5,300
VII	Mjekë dhe ndihmësmjekë	Në strukturat e Policisë së Shtetit:	
	Shef seksioni Mjek Trupë operacionale Ndihmës mjek Trupë shërbimi operacional shofer ambulance Specialist mjek Ndihmës mjek trupë operacionale	- Në repartin special “RENEA”. - Në repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë.	4,000

VENDIM**Nr. 201, datë 15.3.2017**

**PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA
 MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË
 POLICISË SË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja “b”, 4, shkronja “d” dhe 5, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 10 032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve janë sipas lidhjes nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3), e lidhjes nr. 1, është niveli i pagës së punonjësit në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5 dhe 6) të lidhjes nr. 1, jepet sipas funksioneve/pozicioneve të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për

vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë të gradës pasardhëse. Përlllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës së re, sipas ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”.

5. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite pune do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Burgjeve, si dhe në strukturat e Policisë së Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, sipas ekuivalentimit në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

6. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në punë, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

7. Vendimi nr. 1061, datë 18.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi		
1	2	3	4	5	6
			Në funksion të policisë së regjimeve të jashtme, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë së regjimeve të brendshme dhe transferim-shoqërimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale	Në funksion të policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
Bazë	Nëninspektor	40.200	4.000	8.000	
	Inspektor	43.900	4.000	8.000	
	Kryeinspektor	49.300	4.000	8.000	2.000
I mesëm	Nënkomisar	60.000	4.000	8.000	2.000
	Komisar	65.000	4.000	8.000	2.000
	Kryekomisar	89.000	4.000	8.000	2.000
I lartë	Drejtues	101.700			6.500
	Drejtues I	106.000			15.000
Drejtor i Policisë së Burgjeve	Drejtor i Policisë së Burgjeve	110.000			

VENDIM
Nr. 202, datë 15.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të

Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Lidhja nr. I, “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, të Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrave të linjës, institucione qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, që përmendet në pikën 1, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Lidhja nr. II, “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale e vendore”, që përmendet në pikën 2, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja I/1, që përmendet në pikën 3, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në lidhjen II/1, që përmendet në pikën 5, të vendimit, bëhen këto ndryshime:



i) Në klasën XIV shtohet emërtesa: “Manovrator në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

ii) Në klasën X shtohet emërtesa: “Shofer në sektorin e helikopterëve të repartit special “Renea” në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”.

iii) Në klasën IX shtohen emërtesat:

- “Teknik i mesëm në strukturat e teknologjisë së informacionit në sistemin e Policisë së Shtetit”;

- “Roje mjedisore me arsim të lartë”.

iv. Në klasën VIII shtohet emërtesa: “Roje mjedisore me arsim të mesëm”.

d) Në shkronjën “d”, të pikës 9, fjalët “... por jo më shumë se 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.” zëvendësohen me “... por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

dh) Pika 15 riformulohet si më poshtë vijon:

“15. Punonjësit mbështetës, që punojnë në Agjencinë e Inteligjencës dhe të Sigurisë së Mbrojtjes, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi, përfitojnë një shtesë për kushte pune dhe shërbimi, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.”.

e) Pas pikës 18 shtohen pikat 18/1 dhe 18/2, me këtë përmbajtje:

“18/1. Shoferët e urgjencës së spitaleve, për

natyrë të veçantë pune, përfitojnë një shtesë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

18/2. Rojet mjedisore të administratave të zonave të mbrojtura, për natyrë të veçantë pune, përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen, si më poshtë vijon:

- Efektet financiare për shkak të politikës për rritjen e pagave të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikat e reja të pagave.

- Efektet financiare që vijnë si pasojë e rregullimeve teknike të këtij vendimi janë të parashikuara në fondin e pagave të institucioneve buxhetore, për të cilat janë propozuar ndryshimet përkatëse për vitin 2017, dhe do të përballohen nga secili institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. I

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE NË PREFEKTURA.

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	30000
2	II	31600
3	III	32500
4	IV	33400
5	V	34100
6	VI	35250
7	VII	36300
8	VIII	38300
9	IX	39800
10	X	41000



LIDHJA NR. II
NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

Nr rendor	Klasa	Paga bazë Mujore në lekë
1	I	30000
2	II	31600
3	III	32500
4	IV	33400
5	V	34100
6	VI	34500
7	VII	35000
8	VIII	35400
9	IX	36000
10	X	36500
11	XI	37000
12	XII	37500
13	XIII	38200
14	XIV	39800

LIDHJA I/1

RENDITJA E POZICIONEVE TË PËRGJITHSHME TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR
PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E MINISTRIVE TË LINJËS,
INSTITUCIONEVE TË PAVARURA E KUSHTETUESE, INSTITUCIONEVE QENDRORE NË
VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE NË PREFEKTURA

Nr.	EMËRTIMI I PUNONJËSIT	Niveli i pagës klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1	Përgjegjës i sektorit të teknikës në Qendrën e Botimeve Zyrtare	X	5
2	Offsetist në Qendrën e Botimeve Zyrtare	X	
3	Përgjegjës Zyre	IX	5
4	Sekretar Rektori Teknik shtypshkronje, faqesës në Qendrën e Botimeve Zyrtare	IX	
5	Përgjegjës oficine e transporti	VIII	1
6	Sekretar i titullarëve të tjerë Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit dhe të Akademisë së Shkencave Drejtues Skafi në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare Fotoreporter në ATSH Fotograf në ATSH	VIII	
7	Bibliotekar në bibliotekat e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes Restaurator Arkivist. Protokollist Laborant Llogaritar Kontrollor anketimi në INSTAT Topograf	VII	
8	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme Operator në INSTAT Administrator dokumentesh në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe në drejtoritë e arkivave në qarqe Magaziniër	VI	
9	Operator Preparator	V	



	Kolektor Punonjës blegtorie Drejtues mjeteve motorike/motobarke Punëtor i rasateve të peshkut Anketues Shofer për automjete mbi 2.5 tonë dhe automjete speciale		
10	Shofer Shaptilografistë Fotokopjuese Kaldaist Punëtor mirëmbajtës Punëtor porti Punonjës shërbimi	IV	
11	Nëpunës informacioni. Centralist	III	
12	Roje. Korrier. Postier. Lulishtar	II	
13	Punonjës pastrimi/sanitar	I	

VENDIM

Nr. 204, datë 15.3.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT
URBAN, DHE TRANSFERIMIN E TIJ
NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
TE BASHKIA TIRANË, PËR REALIZIMIN
E PAGESËS SË DETYRIMIT TË
PRAPAMBETUR PËR SHOQËRINË
“URBAPLAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, të shtohet fondi prej 27 374 082 (njëzet e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e dy) lekësh, në zërin “Studime, projekte”, për pagesën e detyrimit të prapambetur për projektin “Hartimi i planit rregullues të qytetit të Tiranës”.

2. Fondi, sipas pikës 1, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për transferimin e fondit prej 27 374 082 (njëzet e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e dy) lekësh te Bashkia Tiranë.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 205, datë 15.3.2017

**PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË
NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK
EOLIK, DHËNË SHOQËRISË “ALB-
BUILDING” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në vijim të nenit 31, të vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik eolik, dhënë shoqërisë “ALB-Building” sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

AUTORIZIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2017

PËR

NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK EOLIK
NGA SHOQËRIA “ALB-BUILDING”, SH.P.K

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 31, të vendimit nr.822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

Duke pasur parasysh se:

- a) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., është pajisur me autorizimin paraprak nr.11, datë 27.6.2012, nga ministria përgjegjëse për energjinë, afati i së cilës është shtyrë deri në vitin 2016, për ndërtimin e një parku eolik në zonën Majkosh, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë;
- b) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;
- c) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., ka paraqitur planin e biznesit të projektit;
- ç) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;
- d) OST, sh.a.-ja, ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr.6027/1, datë 4.10.2016;
- dh) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;
- e) Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., ka paraqitur dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me nr. NIPT/NUIS J69102508C, me seli në adresën: rruga “Asim Vokshi”, nd. 14, h. 4, ap. 6, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik eolik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar 12 MWp;
- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike prej 26.076 MWh/vit;
- Numri total i aerogjeneratorëve (kullave eolike) është 6 copë;



- Kapaciteti i një turbine gjeneruese (Aerogeneratori) është 2 MW;
- Lartësia e kullës eolike është 80/92 m;
- Tipi i turbinës gjeneruese VESTAS;
- Diametri i rotorit 100 m;
- Numri i orëve të punës në një vit rreth 2.700 orë punë;
- Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 6 m/s;
- Lidhja e Parkut Eolik Tepelenë, me fuqi të instaluar prej 12 MW, me rrjetin 110 KV të transmetimit, do të bëhet nëpërmjet ndërtimit të një nënstacioni ngritës 110/20 kV të Parkut Eolik Tepelenë, sipas përgjigjes së OST, sh.a.-së, nr.6027/1, datë 4.10.2016, dhënë shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k.;
- Jetëgjatësia e pritshme e parkut eolik është 20 - 30 vjet;
- Vlera e investimit rreth 13.1 milionë €.

1. Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik eolik brenda 7 muajve nga marrja e lejes së ndërtimit.
2. Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., të paraqesë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.
3. Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. Kjo ministri ka të drejtë t’i kërkojë shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.
4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi, midis shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penalitetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.
5. Shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., në përputhje me vendimin nr.1701, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, do t’i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një royalty të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali eolik ose, në rast se kërkohet nga ministria, vlerën korresponduese në lekë të kësaj sasive energjie, së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e royalty prej 2%, të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme që mund të aplikohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.
7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

- a) Me kërkesë me shkrim të shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., për raste të veçanta të justifikuara;




- b) Nëse shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;
 - c) Nëse shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., nuk informon Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit,
 - ç) Vërtetohet se deklaratimet e shoqërisë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., nuk janë të vërteta;
 - d) Kur për shoqërinë “ALB-BUILDING”, sh.p.k., kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas ligjit nr.8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”.
 - dh) Nëse shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., për arsye të shkaktuara nga ajo vetë nuk ka respektuar programin e punimeve dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;
 - e) Nëse shoqëria “ALB-BUILDING”, sh.p.k., nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;
 - ë) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË

DAMIAN GJIKNURI



Pasuritë me nr. : 2/54 dhe 2/53 me sipërfaqe $500 \text{ m}^2 + 500 \text{ m}^2$;

Pasuritë me nr. : 1/156, 1/157, 1/158, 1/159 me sipërfaqe totale 1500 m^2 ;

Pasuria me nr. : 152/3 me sipërfaqe 1000 m^2 ;

Pasuria me nr. : 122/30 me sipërfaqe 1000 m^2 .

Në total një sipërfaqe prej 4500 m^2 , e cila ndodhet në zonën Majkosh, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrë. Në hartë jepet pozicionimi dhe koordinatat e vendndodhjes së secilit nga aerogeneratorët.

**VENDIM****Nr. 206, datë 15.3.2017****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 3 bëhet shtesa me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“- Kryen, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike për projektet e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, sipas tarifave të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me përjashtim të oponencës teknike për punimet e ndërtimit, që kryhet nga institucionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

II. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1**TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE
PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË
KAPACITETEVE PRODHUESE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Tarifat për oponencën teknike për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike janë, si më poshtë:

I. Për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike që janë objekt koncesioni në fazën e studimit të fizibilitetit:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 50 000 lekë.

b) Mbi 1 MW deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 100 000 lekë.

c) Mbi 5 MW deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 300 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

II. Për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike që janë objekt koncesioni në fazën e projektit të zbatimit:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 100 000 lekë.

b) Mbi 1 deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 200 000 lekë.

c) Mbi 5 deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 700 000 lekë.

III. Për ndërtimin e objekteve të prodhimit të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni:

a) Deri në 1 MW tarifa e oponencës do të jetë 100 000 lekë.

b) Mbi 1 MW deri në 5 MW, tarifa e oponencës teknike do të jetë 200 000 lekë.

c) Mbi 5 MW deri në 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 500 000 lekë.

ç) Mbi 15 MW tarifa e oponencës do të jetë 700 000 lekë.

VENDIM**Nr. 207, datë 15.3.2017****PËR SHPALLJEN E QENDRËS
HISTORIKE TË QYTETIT TË KORÇËS
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
MBROJTJEN, KONSERVIMIN E
INTEGRUAR DHE ADMINISTRIMIN E
SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR
PËRRETH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Korçës, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe të zonës së mbrojtur në


qytetin e Korçës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vendimi nr.238, datë 23.3.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullorës për administrimin e saj”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



RREGULLORE PËR MBROJTJEN, KONSERVIMIN E INTEGRUAR DHE ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR NË QYTETIN E KORÇËS

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

1. Mbrojtja, konservimi, mirëmbajtja dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore dhe vlerave

të peizazhit të Qendrës Historike të Korçës.

2. Administrimi i Qendrës Historike të Korçës sipas zonifikimit të paraqitur në hartën që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, si pjesë përbërëse e saj.

3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Korçës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të Qendrës Historike të Korçës.

Neni 2

Kjo rregullore është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë



kulturore”, të ndryshuar, ligjin nr.9386, “Për kartën shqiptare të restaurimit”, miratuar me vendimin nr.426, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, dhe marrëveshjeve e dokumenteve të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore e të peizazhit kulturor, të ratifikuara sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Korçës përbëhet nga:

1. Qendra Historike;
2. Zona e Mbrojtur.
3. Zona me potencial arkeologjik.

Brenda këtyre zonave përfshihen ansamble historike, zona të gjelbra, monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë.

Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Korçës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së zonifikimit të qendrës historike, zonës së mbrojtur dhe zonave me potencial arkeologjik “B”.

Neni 4

Qendra Historike dhe kufijtë e saj

Qendra historike e Korçës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit të Korçës dhe arritjet në arkitekturë dhe urbanistikë.

Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Korçës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

Zona e mbrojtur ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e qendrës historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të reja të qytetit.

Kufijtë e zonës së mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Korçës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Zona me potencial arkeologjik dhe kufijtë e saj

Zona me potencial arkeologjik është pjesë e ish-lagjes “Kala” dhe zona pas godinës së bankës. Kufijtë e zonës me potencial arkeologjik paraqiten

në hartën e zonifikimit të qytetit të Korçës, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

Monumentet e kulturës në qytetin e Korçës, sipas vlerave të tyre historiko – kulturore, ndahen në dy kategori:

1. Monumente të kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale të Korçës. Monumentet e kategorisë së parë ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

2. Monumente të kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistike-arkitekturore, që marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

Neni 8

Ndërhyrjet në Qendrën Historike

Ndërhyrjet restauruese dhe rijetëzuese në Qendrën Historike do të kenë si qëllim mbrojtjen e vlerave arkitektonike të trashëgimisë kulturore të qytetit Korçë. Për të realizuar këtë qëllim, në qendrën historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rijetëzuese në ndërtimet që e përbëjnë si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistike-arkitekturore të Qendrës Historike të qytetit Korçë, brenda kësaj zone kryen këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në qendrën historike, si dhe në monumentet e të dy kategorive bazuar në kriteret për konservimin dhe restaurimin.

2. Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistik-arkitekturore, rrethit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.

3. Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të qendrës historike, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre



arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës historike. Studimet përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që çënojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, zonat ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

4. Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.

5. Ritrajtime dhe rikonstruksione duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

6. Ndalohen ndërtimet e reja në Qendrën Historike me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

7. Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistik-arkitektonik.

Neni 9

Ndërhyrjet në monumente

1. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së parë ruajnë mbarë kompozimin dhe teknikat origjinale si në brendësi, ashtu edhe në pamjet e jashtme. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

2. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së dytë ruajnë volumin fillestar dhe formulimin e pamjes së jashtme, ndërsa në brendësi mund të bëhen ndryshime, duke zbatuar kompozime sipas kërkesave të kohës dhe teknikat e sotme.

3. Në raste kur brenda monumenteve të kategorisë së dytë ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilje arkitektonike me vlerë, këto të fundit ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

Neni 10

Ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur

1. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të vecanta, nuk duhet t'i kalojë 3 katet.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave, etj.

4. Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

5. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale.

6. Ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.

7. Ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës brenda së cilës rruga ndodhet.

8. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kriterëve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 11

Ndërhyrjet në zonën me potencial arkeologjik

1. Sipas pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, në zonat arkeologjike lejohen ndërtimet e reja në rastet e përcaktuara në rregulloren e administrimit të këtyre zonave, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

2. Kur, pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera



arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe veprohet sipas pikave 1, 2, e 3, të nenit 48, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

Neni 12

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe në monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit të monumenteve të kulturës hartohen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga DRKK-Korçë ose prej subjekteve të licencuara për restaurim. Mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori caktohen nga IMK-ja.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektsh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor dhe infrastrukturën nëntokësore hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme, për fushat përkatëse, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK), dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) Korçë. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 13

Shfrytëzimi i monumenteve

Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Kriteret e shfrytëzimit të monumenteve të kulturës, përfshirë “Pazarin e Korçës”, përcaktohen nga Instituti i Monumenteve

të Kulturës, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar. Aktivitetet që do të zhvillohen në to miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë, në bazë të këtyre kriterëve.

Neni 14

Mbrojtja e monumenteve

Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Korçës merr parasysh vlerat e Qendrës Historike, të Zonës së Mbrojtur të dhe zonave me potencial arkeologjik.

Neni 15

Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike

Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike, të Zonës së Mbrojtur si dhe monumenteve të kulturës në qytetin e Korçës, pranë Bashkisë Korçë ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jo vendimmarrëse, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të qytetit. Komiteti ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të përfaqësuesve të banorëve të Qendrës Historike dhe organizmave joshetërore, që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të qytetit të Korçës. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm, që miratohet me 50% +1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.

Neni 17

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi, sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë



7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet zonifikimi i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Korçës.

VENDIM

Nr. 209, datë 15.3.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN, SHESH, PARK PUBLIK, TEATRI ‘PETRO MARKO’”, NË BASHKINË VLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban, shesh, park publik, teatri ‘Petro Marko’”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,

sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 81 331 044 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 81 331 044 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projekti të përballohen nga buxheti i shtetit.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIM URBAN, SHESH PARK PUBLIK TEATRI ‘PETRO MARKO’”

Çmimi i truallit sipas VKM-së nr. 89/2016

Çmimi për banesat konform VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, konfirmuar sipas ZVRPP -së

Çmimi për njësitë e shërbimit, konform VKM-së 138, datë 23.3.2000, sipas çmimeve të EKB-së

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truall dhe ndërtësë	Shënime
1	8603	23/9	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	155.87							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8603	23/10	Vlorë	Shtet	862.75							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	8603	23/47	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	14.83							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8603	23/100	Vlorë	Shtet	18.7							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	8603	23/105	Vlorë	Lulezim Begaj	69		10,903		752,307	0	752,307	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	8603	23/101-T	Vlorë	Bp Begaj	156		10,903		1,700,868	0	1,700,868	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	8603	23/105-ND	Vlorë	Lulezim Begaj		55						Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston, referuar relacionit shpjegues, bashkëlidhur.
8	8603	23/101-ND	Vlorë	Bashkim Begaj		108						Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston, referuar relacionit shpjegues, bashkëlidhur.
9	8603	22/64	Vlorë	Shtet	357.42							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	8603	23/98	Vlorë	Shtet	21.4							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	8603	23/99	Vlorë	Belina Fejzaj	200	160	10,903		2,180,600	2,559,028	4,739,628	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Hipotekohet në favor të Bakës Kombëtare të Greqisë. Vlera e katit përdhe me destinacion njësi shërbimi dhënë sipas situacionit të punimeve.
						160		46,136.20	0	7,381,792	7,381,792	Vlera e katit të dytë me destinacion objekt banimi dhënë sipas çmimit të ZVRPP-së, zbritur vlera e truallit (shkresa bashkëlidhur)
12	8603	23/11-T	Vlorë	Shtet	108.4							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	8603	23/11-ND	Vlorë	Shtet		108.4	10,903	0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston ne terren
14	8603	23/96	Vlorë	Shtet	2396							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	8603	23/66	Vlorë	Shtet	236.13							Konfirmuar nga ZVRPP-ja



16	8603	22/98	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	24.48						Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	8603	22/112-ND	Vlorë	Objekt shtesë e banesë		15.65		0	758,978	2,276,934	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, 3 kate
18	8602	1./9	Vlorë	Shtet shesh para teatrit “Petro Marko”	468.33						Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	8602	1./22	Vlorë	Shtet	29.76						Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	8602	1./7	Vlorë	Shtet	72.17						Konfirmuar nga ZVRPP
21	8603	23/200	Vlorë	Artan Ferati	143	60.5	10,903		1,559,129	0	1,559,129 nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
22	8603	23/210	Vlorë	Aleks Ahmataj	128.8	74.2	10,903		1,404,306	0	1,404,306 Nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
23	8603	23/201	Vlorë	Mustafa Tartari	239	90	10,903	0	2,605,817	0	2,605,817 Nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
24	8603		Vlorë	Objekt pallat me vendim të KRT-së V. Vlorë nr. 3/4, vitit 2010			10,903		0	58,910,263	58,910,263 Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1767 prot., datë 3.3.2017, kërkon përfshirjen e objektit i cili ngrihet mbi pasunitë me nr. 23/200, 23/201, 23/210. Sipas verifikimit faktik, objekti është 5 kate dhe i papërfunduar. Pasuria do të përfshihet për likuidim pas mbarimit të procesit gjyqësor, regjistrimit në ZVRPP dhe marrjes së certifikatës së pronësisë

81.331.044



VENDIM
Nr. 210, datë 15.3.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 678, DATË 16.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI, VËNIA
NË PUNË, ADMINISTRIMI DHE
MIRËMBAJTJA E HIDROCENTRALEVE
TË GOJANIT, GJEGJANIT, PESHQESHIT,
URA E FANIT, FANGUT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 678, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në tabelën që përmendet në pikën 1, bashkëlidhur vendimit, shtohen nënndarjet nr. 393,

394, 395, 396, 397, 398, 399 dhe 400, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pikat 3 dhe 4, të vendimit, ndryshohen me këtë përmbajtje:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 346 011 639.70 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekësh.

4. Shuma e shpronësimit, prej 346 011 639.70 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekësh, të përballohet nga fondet e shoqërisë “AYEN AS Energji” sh.a.”.

3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mirditë dhe shoqëria “AYEN AS Energji” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE TË GOJANIT, GJEGJANIT, PESHQESHIT, URA E FANIT, FANGUT

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë Arë, Ndërtësë

Nr.	Numri i Pronës	Tipi i Pronës	Tipi i pronarit	Të dhëna për pronësinë										Sip. e shpronësimit m ²	Vlera e Shpronësimit në Lekë	
				Emri	Atësia	Mbiemri	Sip. Parceses	Tokë truall	Zona Kadastrale	Fshati	Njësia administrative	Qarku	Vlera e tokës Bulgesore (Lek)			Vlera e Ndërtësës (LEK)
Qarku Lezhe																
1	32/2	Arë	PRIVAT	Ndue	Gjet	Nikolli	750		1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE	173250		750	173250.0
2	35	Arë	PRIVAT	Martin	Kole	Laska	500		1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE	115500		500	115500.0
3	36	Arë	PRIVAT	Martin	Kole	Laska	200		1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE	46200		200	46200.0
4	111/3	Arë	PRIVAT	Gjon	Nikoll	Gjini	350		1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE	80850		350	80850.0
5	352/3	Arë	PRIVAT	Lazer	Nikoll	Gjini	308		1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE	71148		308	71148.0
6	22/2	Arë	PRIVAT	Nikoll	Mark	Kola	740		2933	PESHQESH	OROSH	LEZHE	111000		740	111000.0
7	22/3	Arë	PRIVAT	Mark	Ndue	Marku	520		2933	PESHQESH	OROSH	LEZHE	78000		520	78000.0
8	37/33	Ndërtësë	PRIVAT	Liza	Dod	Nikolli		55	1713	GEZIQ	RRESHEN	LEZHE		2192300	55	2192300.0

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 240 lekë